

Standardi i Përbashkët i Raportimit-CRS

Standardi i Përbashkët i Raportimit (Common Reporting Standard - CRS) i krijuar nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe Direktiva Evropiane 2014/107 / EU (DAC2) mbi shkëmbimin e detyrueshëm automatik të informacionit në fushën e taksave, përbëjnë detyrime të reja rregullatore për institucionet financiare në vendet e detyruara nga sa më sipër (CRS dhe / ose Direktiva Evropiane 2014/107 / EU DAC2) për të mbledhur dhe raportuar informacione mbi llogarinë financiare, me qëllimin për të kontribuar në trajtimin e evazionit fiskal dhe shmangien e taksave, si dhe përmirësimin e përputhjes së taksave në nivel ndërkombëtar. Shqipëria është e përkushtuar të respektojë sa më sipër, në përputhje me Ligjin 4/2020 dhe të gjitha udhëzimet dhe aktet normative në lidhje me të.

Në bazë të sa më sipër, Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a është e detyruar të paraqesë informacionin për llogaritë financiare të Personave të Raportueshëm të mbajtura pranë Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a , çdo vit brenda muajit maj, me të dhënat e vitit kalendarik paraardhës.

Të dhëna të raportueshme sipas ligjit shqiptar të CRS-së

Të dhënat e personave të raportueshëm që duhet të dorëzohen nga institucionet financiare pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për efekt raportimi të Rezidences Fiskale, përfshijnë si më poshtë:

Emri i plotë i individit / Emri i Kompanisë, Adresa (at), Juridiksioni (et) e vendbanimit tatimor, Numri Identifikues i Tatimpaguesit, data dhe vendi i lindjes (vetëm për individët), numri i llogarisë(ve), balanca / vlera e depozitës ose e llogarisë së kujdestarisë.

Llogaritë "e përjashtuara" nuk raportohen

Në këtë drejtim, ligjvënësi ka përcaktuar edhe përjashtime të caktuara për llogari të cilat nuk janë llogari financiare të raportueshme.

Personat që nuk raportohen:

Për më tepër, një përjashtim ekziston për klientë të veçantë që nuk përcaktohen si "persona raportues". Këto janë institucione financiare, entitete qeveritare, organizata ndërkombëtare, bankat qendrore, korporata aksionet e së cilës tregtohen rregullisht në një ose më shumë tregje të letrave me vlerë të themeluara (ose entitete të lidhura me të).

Është e rëndësishme që të theksohet se kompania e ka të ndaluar që të japi ndonjë këshillë fiskale dhe ligjore.

Informacione më të hollësishme në lidhje me Standardin e Përbashkët të Raportimit të OECD mund të gjenden në Portalin e Shkëmbimit Automatik të OECD

[Klikoni këtu Linkun](#)

dhe në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve:

[Klikoni këtu Linkun](#)

Ju lutem plotesoni Formen e Vete-Deklarimit ne varesi te kategorise ne te cilen beni pjese, sipas menyrave ne vijim:

-Duke u paraqitur ne nje nga deget e Sigal se bashku me dokumentin tuaj te identitetit te vlefshem (Karte Identiteti ose Pasaporte).

-Ne pamundesi per t'u paraqitur prane Sigal, ju mund t'i shkarkoni keta formulare, nenshkruali dhe me pas t'i dergoni te skanuara ne adresen e elektronike aml@uniqa.al.

Ju lutemi sigurohuni qe t'i keni plotesuar sakte keto dokumente para se t'i dergoni në kompani.



vetedeklarim per
Subjekte.pdf



Self Certification
for entities.pdf



vetedeklarim per
individe.pdf



self certification
individual.pdf